



PER NJE SHOQERI ME TE ZHVILLUAR

Në këtë numër:

- Përvjetori i 20-të i Partnerëve për Ndryshim Demokratik ! faqe 1

- Rritja e vizibilitetit të gruas dhe rolit të saj në vendimmarrjen vendore dhe qendrore faqe 2

- Krijimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për promovimin e proceseve konsultative me pjesëmarrje në hartimin e politikave në Shqipëri faqe 2

- Vlerësim i Shërbimeve të QKR-së faqe 3

- Përfshirja e Partnerëve-Shqipëri në programe në fushën e përkatësisë gjinore faqe 3

- Forcimi i Kapaciteteve të Sektorit Jo-fitimprurës", një program i ri asistence i Partnerëve-Shqipëri faqe 4

- TE TJERA - Trainime në Gazetari Investigative faqe 2

**Të nderuar kolegë dhe bashkëpunëtorë!
Në këtë fillim viti, stafi i Partnerëve Shqipëri
Ju paraqet urimet më të ngrohta dhe
të singerta për një vit të mbarë dhe të
suksesshëm 2010!**

Përvjetori i 20-të i Partnerëve për Ndryshim Demokratik!

Në Nëntor 2009, anëtarët e Rrjetit Ndërkombëtar të Partnerëve për Ndryshim Demokratik u mbledhën në Washington DC për të festuar përvjetorin e 20-të të krijimit të Partnerëve për Ndryshim Demokratik (PND) në SHBA. PND është themeluesja e të gjitha qendrave anëtare të rrjetit, që veprojnë në 20 shtete të ndryshme në katër kontinente.

Me këtë rast, PND organizuan Konferencën **"Risi për të Nesërmen"**, të bashkë-financuar nga Qendra për Marrëdhënie Transatlantike në Shkollën Paul H. Nitze për Studime të Avancuara Ndërkombëtare, në Universitetin Johns Hopkins.

Konferenca "Risi për të Nesërmen" mbledhi akademikë dhe praktikantë të kësaj fushe në një seri seminaresh që reflektonin eksperiencën e Qendrave në çështje si vlerësimi i programeve të demokracisë dhe qeverisjes, ndryshimit të klimës, minoriteteve në Europën Qendrore dhe Lindore dhe objektivave të zhvillimit.

Partnerët-Shqipëri prezantoi eksperiencën shqiptare në **Pjesëmarrjen qytetare në Proceset Zgjedhore dhe Rolin e Qytetarëve në Promovimin e Transparencës dhe Përmirësimin e Vendim-marrjes**. Këto raste studimore mund të shkarkohen në faqen e internetit të Partnerëve Shqipëri në linkun: <http://www.partnersalbania.org/?fq=brenda&m=news&lid=37&gj=gj1> Për më shumë informacion mbi seminarët vizitoni faqen e internetit të PND <http://www.partnersglobal.org/celebrating-20-years-of-partners>

Duke promovuar një "bisedë" me liderët kryesorë



në fushën e politikave dhe të fondacioneve, Konferenca u fokusua në tre deficite kritike që dëmtojnë zhvillimin ndërkombëtar: Lider shipi, Ndërtimi i kapaciteteve, dhe Qëndrueshmëria e përpjekjeve.

Cilat janë politikat e reja, risitë dhe mundësitë e parashikuara nga Këshilli Kombëtar i Sigurimit, Departamenti i Shtetit, USAID, Banka Botërore dhe fondacionet që adresojnë këto deficite të cilat pengojnë reformat afatmesme dhe afatgjata?

Gjatë evenimentit, PND shfrytëzoi mundësinë për të vlerësuar katër njerëz për kontributin e tyre në punën e Partnerëve: William S.White , President i Fondacionit Charles Stewart Mott dhe Robert L. Corcoran, President i Fondacionit General Electric, Dusan Ondrusek nga Partnerët Sllovaki për trainimet e shumta të ofruara në temën e manaxhimit të konfliktit dhe Daniela Kolarova nga PDCI për përkushtimin e saj në ngritjen e Rrjetit Ndërkombëtar të Partnerëve për Ndryshim Demokratik.

Rritja e vizibilitetit të gruas dhe rolit të saj në vendimmarrjen vendore dhe qendrore

Në Nëntor 2009 PSh filloi zbatimin e një projekti të ri të titulluar **"Rritja e vizibilitetit të gruas në vendimmarrjen vendore dhe qendrore"**, si pjesë e një projekti të madh tre – vjeçar **"Forcimi i Rolit të Gruas në Qeverisje"**, mbështetur nga OSBE dhe financuar nga SIDA dhe Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë.

Projekti do të kontribuojë në promovimin e grave lidere dhe rritjen e numrit të grave të zgjedhura në institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore, nëpërmjet rritjes së vizibilitetit të tyre.

Gjatë Nëntorit dhe Dhjetorit, Partnerët përgatitën një plan të detajuar aktivitetesh dhe vijuan me organizimin e tetë forumeve rajonale në Fier, Vlorë, Berat, Kuçovë, Sarandë, Tepelenë, Përmet dhe Gjirokastër, për t'u dhënë një mundësi 138 grave pjesëmarrëse në këto forume për të krijuar një profil të tyrin në jetën publike. Pjesëmarrëset ishin gra drejtuese nga forume politike, shoqëria civile, sektori i biznesit dhe përfaqësuese të administratës publike dhe qarqeve akademike.

Aktivitetet në vijim do të përfshijnë kryerjen e 12 trainimeve dy-ditore në integrim gjinor dhe të drejtat

Krijimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për promovimin e proceseve konsultative me pjesëmarrje në hartimin e politikave në Shqipëri

"Krijimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për promovimin e proceseve konsultative me pjesëmarrje në hartimin e politikave në Shqipëri", financuar nga Balkan Trust for Democracy është projekti më i ri i Partnerëve Shqipëri që nisi zbatimin në Dhjetor 2009. Ky projekt synon të krijojë kapacitete të organizatave të shoqërisë civile shqiptare për të advokuar dhe marrë pjesë në mënyrë më efektive në proceset konsultative të sponsorizuara nga qeveria mbi hartimin e politikave dhe strategjive nëpërmjet zhvillimit të aftësive monitoruese, advokuese dhe të krijimit të rrjeteve.

Projekti do të zgjasë dhjetë muaj dhe do të përfshijë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga Veriu, Jugu dhe Shqipëria e Mesme, si dhe përfaqësues të administratës publike nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile do të trajnohen si të advokojnë e të marrin pjesë në hartimin e politikave si dhe në hartimin dhe amendimin e ligjeve përkatëse që janë në axhendën e këtyre ministrive përgjatë vitit 2010, ndërsa përfaqësuesit e administratës publike do të trajnohen si të përfshijnë shoqërinë civile në proceset konsultative me pjesëmarrje.

Si aktivitete të fazës së parë të projektit, Partnerët-Shqipëri organizuan takime paraprake me përfaqësues të ministrive për të lehtësuar dialogun ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë.



e grave, për këshilltarë bashkiakë dhe komunarë, staf të administratës dhe drejtues politikë në nivel lokal. Më tej PSh do të lehtësojë 24 diskutime në komunitet me gra dhe burra në lidhje me shërbime publike vendore si ndihma sociale, manaxhimi i mbetjeve të ngurta, pastrimi i qytetit, arsimit, kujdesi shëndetësor, furnizimi me ujë etj, parë këto në këndvështrimin gjinor.

Trainim në Gazetari Investigative

Në Dhjetor 2009, Partnerët Shqipëri u kontraktuan nga Programi i Shtetit Ligjor për Shqipërinë për të organizuar dy trainime dy-ditore në "Gazetarinë Investigative" për gazetarë të rajoneve të Shkodrës dhe Vlorës. Pjesëmarrësit ishin 51 gazetarë të medias lokale elektronike dhe të shkruar si dhe korrespondentë të mediave kombëtare në këto rrethe. Trainimet synuan rritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve duke u ofruar atyre instrumente dhe teknika të reja të gazetarisë investigative si një mjet efektiv i monitorimit dhe angazhimit qytetar kundër korrupsionit.

Programet u ofruan nga një trainer nga Kroacia, me një eksperiencë 30 vjecare si gazetar dhe i autorizuar si trainer i gazetarisë investigative dhe konsulent i medias në shkallë ndërkombëtare.

PSh lehtësuan trainimet duke përdorur një metodologji me pjesëmarrje që mundësoi gazetarët të ndanin eksperiencat në fushën e gazetarisë investigative dhe të diskutonin mbi raste reale të praktikave korruptive të raportuara nga media lokale.



Vlerësim i Shërbimeve të QKR-së

Partnerët Shqipëri po kryen një vlerësim të shërbimeve të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në drejtim të konsistencës, cilësisë, profesionalizimit, transparencës, drejtësisë dhe efektivitetit. Partnerët Shqipëri është përzgjedhur mes OJF-ve të tjera që konkuruan për këtë detyrë në Programin Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë 2, komponenti i Mbështetjes së Iniciativave Monitoruese të Shoqërisë Civile.

Vlerësimi fokusohet gjithashtu në bashkëveprimin e QKR me agjencitë e tjera qeveritare me interes të madh për komunitetin e biznesit në Shqipëri, të tilla si Departamenti i Përgjithshëm i Tatimeve, Inspektorati i Punës, etj

Kjo nismë do të përfshijë monitorimin e 17 sporteleve të QKR, tre në Tiranë dhe 14 rrethe të tjera.

Monitorimi do të mbulojë:

- të gjitha shërbimet e QKR ;
- të gjitha fazat e ofrimit të shërbimeve në sportelet e QKR, nga marrja e dokumentacionit deri në dhënien e çertifikatave;
- Përvijën e klientëve si me sportelet e shërbimit ashtu edhe me faqen e internetit të QKR;
- Bashkëveprimin e QKR me agjencitë tjera qeveritare.

Përfshirja e Partnerëve-Shqipëri në programe në fushën e përkatësisë gjinore

Përgjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2009, Manaxherët e trainimeve të Partnerëve Shqipëri u përfshinë në kryerjen e një serie aktivitetesh me fokus përkatësinë gjinore:

- **Trainim në fushën e përkatësisë gjinore për mësuesit e shkollave të mesme.**

Programi i trainimit ofruar në Shkodër për mësuesit e shkollave të mesme të rajonit të Shkodrës ishte pjesë e programeve ekstra kurrikulare për shkollat e mesme në Shqipëri i cili filloi më herët me përgatitjen e një libri të Përkatësisë Gjinore për këtë target grup.

- **Program trainimi për bashkinë e Vorës në "Bazat e Përkatësisë Gjinore për Pushtetin Vendor".**

Trainimi i ofruar është pjesë e një serie programesh të ngjashme që synojnë rritjen e aftësive dhe kapacitetet e bashkive shqiptare në përgatitjen e planeve dhe zbatimin e politikave që nxisin barazinë gjinore, në kuadër të mbështetjes që projekti Equity in Governance (Barazi në Qeverisje) po ofron për Drejtorinë e Shanseve të Barabarta në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në zbatim të Planit Kombëtar për Barazinë Gjinore.

- **Trainim dhe ekspertizë për përfaqësues të Bashkisë së Lezhës** në "**Buxheti në këndvështrimin gjinor**", në kuadër të Projektit të UNIFEM-it "**Si të përmirësojmë procesin e monitorimit të politikave dhe buxhetit nga perspektiva gjinore**".

- **Integrimi Gjinor në Pushtetin Vendor.**

Tre manaxherët e trainimeve të PSh morrën pjesë në një program trainimi "Training of Coaches" organizuar nga projekti EIG. Ky ekip i PSh po punon me projektin për të zhvilluar një Manual të Integrimit Gjinor që do të zbatohet në gjashtë bashki shqiptare. Manaxherët e trainimeve të PSH do të jenë pjesë e grupit të trainerëve (coaches) që do të asistojnë bashkitë në hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për integrimin gjinor.

"Forcimi i Kapaciteteve të Sektorit Jo-financiar", një program i ri asistence i Partnerëve-Shqipëri

Partnerët Shqipëri kreu një vlerësim të shpejtë të nevojave për ndërtim kapacitetesh institucionale të një grupi OJF-sh. Në kushtet kur financimet e donatorëve po pakësohen dhe gara për fonde po bëhet më e vështirë, nuk është surprizues fakti që manaxhimin financiar dhe ngritja e fondeve evidentohen si fusha kryesore ku ka nevojë për asistencë.

Pothuaj 100% e organizatave që u përgjigjën kanë identifikuar si nevojën më të madhe **çështjet fiskale** (detyrimet fiskale, raportimi dhe manaxhimi i OJF-ve), ndjekur nga aftësitë në ngritjen e fondeve. Si pasojë e ndryshimeve të shpeshta në kuadrin ligjor për OJF-të dhe ekspertizës së limituar të burimeve njerëzore në manaxhim financiar nga ana e sektorit, kjo çështje mbetet shumë prioritarë në nevojat e OJF-ve. Si rrjedhojë e kompleksitetit të saj dhe asistencës së munguar deri më tani për sektorin, kjo është një

nevojë e përgjithshme pavarësisht madhësisë së OJF-së ose eksperiencës së saj në manaxhimin e fondeve.

Çështjet e tjera të asistencës që vijojnë janë **Shkruajtja e Propozimeve dhe Manaxhimi i Projekteve, Ndërmarrjet Sociale dhe Manaxhimi i Burimeve Njerëzore.**

Ka një kërkesë më të ulët për *Mobilizimin e Komunitetit dhe Procedurat dhe Politikën e Brendshme.*

Bazuar në këto gjetje, Partnerët Shqipëri do të lançojë në Mars të këtij viti trainimet e hapura për sektorin, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në program. Përmë shumë informacion referojuni këtij linku: <http://www.partnersalbania.org/?fq=brenda&m=shfaqart&aid=191>